



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE G. - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:158445
Datë: 26.12.2024
Numri i dokumentit: 06655613

P.nr.101/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE G.-DEGA MALISHEVË -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren Juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.M., për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPPK-së e sipas aktakuzës PP/II.nr.414/23 të dt. 19.07.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.10.12.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari S.M, ndërsa në mungesë të dëmtuarit, me dt.11.12.2024, shpallë, ndërsa me dt.26.12.2024, e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: S.M nga i ati R. dhe e ëma A.e e lindjes K., i lindur me dt....., në G. me banim në fshatin D. K. Malishevë, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R të Kosovës, i pa martuar, , ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se Gjatë muajit Dhjetor të vitit 2022 në fshatin D. K-Malishevë, i pandehuri me qëllim që vetit t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t'i shkaktojë dëm të dëmtuarit D.M., nuk i përmbush detyrimet ose i keqpërdor autorizimet, në atë mënyrë që i pandehuri duke e shfrytëzuar faktin se vëllai i tij-i dëmtuari e kishte lejuar të banojë në shtëpinë e tij, i njëjti për të paguar borxhet që kishte ndaj kushërinjve të tij, nga shtëpia e të dëmtuarit merr një frigorifer të firmës „B.” në vlerë prej 800€, si dhe një Ca. (s.) në vlerë prej 1500 marka dhe të njëjtat ua jep kushërinjve të tij si pagesë e borxhit ndaj tyre, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49 dhe nenin 330 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtin e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej **katërqind euro (400€)**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e cekur, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditësh, duke llogarit çdo njëzet (20) euro në një (1) ditë burgu.

- Si dhe me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muajve** të cilin dënim gjykata nuk do ta ekzekutoj në afatin kohorë prej 1 (një viti nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

URDHËROHET Shërbimi Sprovës i Kosovës në G. që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në G..

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej njëzet (20) euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej njëzet (20) euro, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

I dëmtuari D.M. nga fsh. D. K. Malishevë, lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në G., me aktakuzën PP/II.nr.414/23 të dt. 19.07.2023, e ka akuzuar S.M, për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 10.12.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari S.M., nuk ka prezantuar i dëmtuari D.M., i cili sipas flete kthesës gjendet në G., nuk ka prezantuar i autorizuari i të dëmtuarit, av. Haki Kyreziu edhe pse ka qënë i njoftuar nga seanca e kaluar e dt. 07.11.2024, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari S.M., në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilat ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilën jam penduar, e di që kam gabuar, kam mbetur pa para dhe ia kam shitur gjërat e vëllait, pas bisedës me vëllain jemi pajtuar, po ashtu deklaroj se për dëmin që ia kam shkaktuar vëllait unë do ti përgjigjem, andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh rrethanat lehtësuese me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit dhe te me shqiptohet një dënim më i butë, ku i premtoj gjykatës që në të ardhmen do te jem më i kujdesshëm të mos bije ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit Venera Shala në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari S.M, pasi që ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetarë, pa presion duke i ditur pasojat dhe benifitet e një pranimi të tillë. Si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj gjykatës që te ketë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale të kryer, premtimin se nuk do te përsërisë më asnjë vepër penale, ndërsa si rrethanë rënduese kërkoj nga gjykata që të ketë parasysh përgjegjësinë penale këtu të akuzuarit, shkallen e lartë të dashjes së tij për kryerjen e veprës penale e po ashtu edhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale, andaj propozoj që i njëjti të shpallet fajtori, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari S.M me dashje ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykim

Gjendjen e këtyllë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i oficerit S.K., dt.30.12.2022;
- Deklarata e të pandehurit S.M, e dhënë në polici me dt.30.12.2022;
- Deklarata e të dëmtuarit D.M. e dhënë në polici me dt.30.12.2022;

- Deklarata e të dëshmitarit A. M., e dhënë në polici me dt. 30.12.2022;
- Deklarata e të dëshmitarit B. M. e dhënë në polici me dt. 30.12.2022;;
- Si dhe shkresat tjerë në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 330 par.1 është paraparë se „ *Kushdo që gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t'i shkaktojë dëm personit interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet..*

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin S.M e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, i njëjti është i pa punë dhe i gjendjes së dobët ekonomike, është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, ka deklaruar se me të dëmtuarin respektivisht vëllain e tij D. janë pajtuar dhe sa i përket dëmit unë do ti përgjigjem, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori faktin se i njëjti ka qenë edhe me parë i dënuar nga kjo gjykatë, sipas aktgjykimeve P.nr.187/21 i i plotfuqishëm me dt.21.12.2021, P.nr.125/22 i plotfuqishëm me dt. 16.12.2022, P.nr.54/23 i plotfuqishëm me dt. 27.02.2024, andaj gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro si dhe dënimin me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për udhëzimin në kontestin civil

Vendimin udhëzimin në kontestin e rregullt civil gjykata e mbështeti ne nenin 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE G.-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.101/24, me dt. 11.12.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.